



Agjencia Kombëtare e Rinisë

Termet e Referencës

Këshilltar i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Titulli i Pozitës

Këshilltar i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Kohëzgjatja

12 muaj

Vendndodhja

Agjencia Kombëtare e Rinisë, Tiranë

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) është institucion i cili garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke organizuar përgjegjësitë funksionale me qëllim sigurimin e kushteve për mbështjetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri.

Konteksti

Këshilltari i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për ofrimin e ekspertizës profesionale komunikimi për të gjitha aktivitetet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR), në funksion të vizibilitetit të aktiviteteve, projekteve dhe programeve të zbatuara nga AKR. Bashkëpunim me institucione publike dhe organizata jofitimprurëse në hartimin e analizave ligjore, raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve për ndryshime ligjore në interes të AKR-së

Përshkrimi i Punës

- ✓ Jep këshillim ligjor për projektet e financuara nga CFCU dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë.
- ✓ Asiston dhe jep opinion mbi kontrata, marrëveshje bashkëpunimi, udhëzime apo dokumente të tjera ligjore të lidhura me zbatimin e projekteve.
- ✓ Siguron që procedurat e prokurimit, nënshkrimit të kontratave dhe raportimit janë në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar dhe rregullat e BE-së.
- ✓ Ndihmon në përgatitjen e përgjigjeve për auditime apo kontrole nga autoritetet vendase dhe ndërkombëtare.
- ✓ Jep këshilla ligjore mbi çështje të tjera të nevojshme për funksionimin e projekteve ndërkombëtare.

Kualifikimet dhe Përvoja

- Minimumi 5 vite përvojë si ekspert ligjor.
- Njohuri të thelluara në fushën e rinisë si dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërpersonale.
- Aftësi për të koordinuar dhe menaxhuar disa aktivitete në të njëjtën kohë.
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze.

Procesi i Aplikimit

- Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivuese duke detajuar përvojën e tyre relevante deri më datë 14.10.2025 ora 14:⁰⁰ në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Kriteret e Vlerësimit

- Kriteret për vlerësimin e aplikimeve do të jenë:
 - **Faza 1:** Kualifikimet dhe përvoja të cituara në pikën Kualifikimet dhe Përvoja të këtij dokumenti;
 - **Faza 2:** Performanca në intervistë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. (Aplikantët që kalojnë fazën e parë do lajmërohen zyrtarisht për ditën dhe orën e intervistës)

Afati për Aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen deri më datë 14.10.2025 ora 14:⁰⁰ në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al ose fizikisht pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një punëdhënëse me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë dhënë si një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit bazuar në nevojat në zhvillim të organizatës.
